

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-128/13**

**Prishtinë,**

**26 Mars 2014**

Në çështjen juridike të

**S. L.**

R. 4.

85. B.

M. Z.

***Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese***

kundër

**Nuk dihet**

***Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esma Erterzi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA91264), të datës 5 shtator 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 26 mars 2014, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Anulohet vendimi KPCC/D/A/164/2012, i datës 5 shtator 2012, në pjesën që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA 91264 pasi që ai është marrë në mungesë të juridiksionit.
2. Hedhet poshtë si e papranueshme kërkesa e S. L.-it, e regjistruar me numrin KPA91264.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 14 nëntor 2006, S. L. ka paraqitur një kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e ngastrave kadastrale me numrat 107/2, 108, 110, dhe 114, që ndodhen në komunën e Deçanit në Ratish të Epërm, zona kadastrale Ratish e Epërme, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3ha, 95ari e 45m<sup>2</sup>. Ai ka pretenduar se është pronar i pronës në Ratish të Epërm, të cilën ai e ka trashëguar nga nëna e tij sipas kontratës për mbajtje afatgjatë, të datës 27 shtator 1985.
2. Më tej, në formularin e kërkesës theksohet se duke nënshkruar formularin paraqitësi i kërkesës vërteton se prona private është humbur si rezultat i rrethanave të periudhës 98/99 në Kosovë dhe se data e humbjes është 12/06/1999.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, S. L. ka dorëzuar kopjet e një ekstrakti nga fleta poseduese nr. 18, komuna kadastrale Gornji Ratis, 12 qershor 1992, duke futur në listë *inter alia* ngastrat kadastrale me numrat 107, 108, 110, dhe 114. S. L. po ashtu ka dorëzuar një kopje të kontratës për mbajtje afatgjatë, të lidhur më 27 shtator 1985 në Bar ndërmjet S. L. nga Bar-Rena, si mbajtës në njërën anë dhe L. V., mbiemri i vajzërisë V. nga fshati G. Ratis, komuna e Deçanit, me banim në Bar që nga viti 1983, tek mbajtësi, si e mbajtura në anën tjetër. Kontrata është nënshkruar në Gjykatë në Bar të Republikës së Malit të Zi më 1 tetor 1985. Po ashtu është dorëzuar edhe kopja e certifikatës së vdekjes të nënës së paraqitësit të kërkesës, të lëshuar në Bar më 18 tetor 2007, që vërteton vdekjen e V. L., mbiemri i vajzërisë V., më 24 nëntor 1987.
4. Më 2 shkurt 2010, AKP-ja ka konfirmuar saktësinë e pronës së kërkuar që ka të bëjë me ngastrën nr. 108 me hartën kadastrale, ortofotot dhe koordinatat e GPS--t.

5. Më 18 shkurt 2010, AKP-ja ka verifikuar negativisht fletën poseduese nr. 18, të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës. Sekretaria Ekzekutive vërtetoi *ex officio* se të gjitha ngastrat ishin regjistruar në emër të disa bashkëpronarëve, trashëgimtarë të V. L. dhe se ky regjistrim ishte bërë në vitin 1997.
6. Me vendimin grupor KPCC/D/A/164/2012, të datës 5 shtator 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) refuzoi kërkesën. Komisioni ka konsideruar se paraqitësi i kërkesës kishte paraqitur një kontratë për mbajtje afatgjate të vitit 1985 të lidhur ndërmjet paraqitësit të kërkesës dhe nënës së tij; sipas kontratës paraqitësi i kontratës duhej të “caktohej” pas vdekjes së nënës së tij si trashëgimtar i saj; kontrata për mbajtje afatgjate përcaktonte se katër hektarë të pronës së nënës së tij do t'i jepeshin personit të quajtur V. L. pas vdekjes së nënës së paraqitësit të kërkesës; aty nuk ceket se cilat ngastra apo cila pjesë e tyre do t'i lihej V. L. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* fletën poseduese nr. 18, ku prona e kërkuar ishte shënuar në emër të trashëgimtarëve të V. L. në vitin 1997. Më pas, Sekretaria ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës dhe kërkoi që ai të dorëzojë prova shtesë për ta dëshmuar të drejtën e tij pronësore; megjithatë ai nuk e bëri këtë.
7. Vendimi i KKPK-së iu dorëzua paraqitësit të kërkesës më 15 prill 2013.
8. Ai paraqiti ankesë më 10 maj 2013 duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së mbi bazën e gabimit thelbësor dhe zbatimit të gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale në fuqi, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve.

**Pranueshmëria e ankesës:**

9. Ankesa është paraqitur me kohë. Prandaj ajo është e pranueshme.
10. Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (në tekstin e mëtejme Ligji), pala mund të paraqes ankesë brenda (30) ditëve nga dita e njohimit të vendimit.

**Vlefshmëria e vendimit dhe juridiksioni:**

11. Vendimi i KKPK-së është dashur të anulohet pasi që është marrë në mungesë të juridiksionit.
12. Sipas nenit 3.1 të Ligjit, Komisioni ka kompetencë për t'i zgjidhur kërkesat që ndërlidhen me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999 dhe kërkesat që lidhen me të drejtat të cilat nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rrjedhin nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
13. Në kontekstin e fakteve të vërtetuara, duhet të pranohet se humbja e pretenduar e pronës në asnjë mënyrë nuk është e lidhur me konfliktin e armatosur që ndodhi në Kosovë në periudhën 1998/1999. E ëma e paraqitësit të kërkesës ka vdekur në vitin 1987 në Bar të Malit të Zi. Më pas, në vitin 1997 pronat ishin regjistruar në kadastër në emrat e trashëgimtarëve të V.L.. Nuk ka ndonjë të dhënë se para apo pas vitit 1997 – do të thotë para konfliktit të armatosur, paraqitësi i kërkesës ka qenë në posedim të tokave dhe/ose se ato kanë qenë të regjistruara në emrin e tij. Ka ekzistuar një kontratë në dobi të tij dhe në dobi të V. L. e datës 1985, e nënshkruar nga nëna e paraqitësit të kërkesës. Ajo ka vdekur në vitin 1987 dhe 10 vite më vonë pronat ishin regjistruar në emrat e trashëgimtarëve të L.ć (fleta poseduese, e paraqitur nga paraqitësi i kërkesës është vërtetuar negativisht). Kjo çon në konkludimin e vetëm se edhe nëse paraqitësi i kërkesës ka pasur disa të drejta lidhur me këto prona, humbja e pretenduar e tyre nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999.
14. Të dhënat në lëndë çojnë në një kontest hipotetik pronësor ndërmjet paraqitësit të kërkesës dhe trashëgimtarëve të V. L., që fillon në vitin 1987, kur kishte vdekur nëna e paraqitësit të kërkesës. Ky lloj kontesti megjithatë nuk është në juridiksionin e kësaj Gjykatë e as të KKPK-së në procedurën aktuale. Sikurse u cek më lartë, nuk ndërlidhet me ngjarjet e vitit 1998/1999.
15. Në bazë të të lartcekurave dhe sipas dispozitës të nenit 12.2 të Ligjit Nr. 03/L-079 dhe nenit 198, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it**

**Shukri Sylejmani, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**